

## Leja për mësimin e gjuhës – Të mësosh luksemburgisht gjatë orëve të punës

<b>Organizmat e kontaktit</b> <a href="#">Ministria e punës</a> 26, rue Zithe L-2939 Luxembourg Tél.: +352 24 78 61 00 Fax: +352 24 78 61 08 Courriel: info@mte.public.lu	<b>Formularët</b> <a href="#">e kërkesës për dhënien e lejes - punonjësit me rrogë faza e I</a> <a href="#">e kërkesës për dhënien e lejes - punonjësit me rrogë faza e II</a> <a href="#">Deklarata e rimbursimit - punëdhënësi</a> <a href="#">e kërkesës për dhënien e lejes - punonjësit e pavarur faza e I</a> <a href="#">e kërkesës për dhënien e lejes - punonjësit e pavarur faza e II</a> <a href="#">Deklarata e rimbursimit - punonjësi i pavarur</a>
---	---

### Për çfarë bëhet fjalë ?

Leja për mësimin e gjuhës u lejon të huajve që punojnë në territorin luksemburgëz të ndjekin gjatë orarit të punës kurse gjuhe për të mësuar luksemburgisht apo perfeksionuar kompetencat e tyre në këtë gjuhë.

Gjatë kësaj leje rrogëtari ka të drejtë të paguhet për orë njëloj si të ishte në punë (maksimumi 4x e rrogës sociale minimale për orë për punonjësit e pakualifikuar). Shteti i rimbursion punëdhënësit shumë e rrogës së punonjësit si edhe pjesën e kontributeve shoqërore që i takojnë atij. Personat që kanë një aktivitet të pavarur apo të lirë kanë gjithashtu të drejtë gjatë lejes për mësimin e gjuhës për një shpërblim kompensues i cili llogaritet duke u nisur nga të ardhurat që kanë shërbyer si bazë për sigurimin e pensionit gjatë vitit të fundit fiskal. (maksimumi 4x e rrogës sociale minimale për orë për punonjësit e pakualifikuar).

Kohëzgjatja e lejes për mësimin e gjuhës është 200 orë të ndara detyrimisht në dy faza : e para prej 80 orësh dhe e dyta prej 120.

### Kushtet që duhen plotësuar

Aplikanti duhet që:

- Të jetë punonjës me rrogë në territorin luksemburgëz ose të ushtrojë një aktivitet të pavarur apo të lirë në këte territor ;
- Të ketë një vjetërsi pune prej të paktën 6 muajsh pranë të njëjtit punonjës, respektivisht të jetë vendosur në Luksemburg si i pavarur apo me profesion të lirë qe prej të paktën gjashtë muajsh
- Të disponojë një autorizim qëndrimi të vlefshëm.

Kursi i gjuhës për të cilin kërkohet leja duhet të jepet nga :

- Institucione që kanë statusin e shkollës publike apo private e njohur nga autoritetet publike ; Po kështu dhe çertifikatat e lëshuara nga këto institucione duhet të njihen nga të njëjtat autoritete;
- Dhomat profesionale apo njësitë bashkiake;

- Shoqata private të pranuar për këtë qëllim nga ministri e që kanë formimin profesional në kompetencat e tyre.

*Vërejtje : Jo kusht moshe apo rezidence por aktivitet me rrogë ose të pavarur në Luksemburg !*

### Si duhet aplikuar

Kërkesa i duhet drejtuar Ministrisë së Punës nëpërmjet formularit të kërkesës për këtë qëllim (i disponueshëm në adresën e internetit [www.mte.etat.lu](http://www.mte.etat.lu) apo në adresën [www.bienvenue.lu](http://www.bienvenue.lu)). Në rastin e punëtorëve me rrogë duhet të lajmërojnë paraprakisht punëdhënësin (shih « Të ndryshme – Për tu ditur »). Kërkesa duhet të përmbajë llojin e formimit, kohëzgjatjen, organizmin formues dhe periudhat për të cilat kërkohet leja.

Duhet bërë kërkesë e veçantë për secilën nga fazat e lejes për mësimin e gjuhës.

Për fazën e parë prej 80 orësh duhet të bashkëngjiten këto dokumenta:

Çertifikata(t) e regjistrimit në kursin e gjuhës me informacion mbi numrin e orëve të formimit (provimet, orët, etc.) ;

- Kopje e kontratës së punës (për rrogëtarët) ;
- Një certifikatë regjistrimi në sigurimet shoqërore e kohëve të fundit ;

Për fazën e dytë prej 120 orësh duhet të bashkëngjiten këto dokumenta :

- Diplomë apo certifikatë që kursi i fazës i parë u kalua me sukses;
- Një certifikatë regjistrimi në sigurimet shoqërore e kohëve të fundit.

### Të ndryshme – Për tu ditur

Lajmërimi i punëdhënësit:

Nëse punëdhënësi pranon kërkesën e lejes për mësimin e gjuhës së një punëtori me rrogë, ai mund t'i kërkojë këtij të fundit një certifikatë pjesëmarrje në kursin e formimit.

Punëdhënësi mund ta refuzojë kërkesën e lejes për mësimin e gjuhës nëse aplikanti është një kuadër i lartë ose nëse ndërmarja ka më pak se 15 punëtorë me rrogë.

Punëdhënësi mund të shtyjë lejen për mësimin e gjuhës (maksimumi 1 vit nëse kohëzgjatja e lejës së kërkuar është 3 muaj apo më pak dhe maksimumi 2 vjet nëse kohëzgjatja e lejës së kërkuar i kalon 3 muajt) në rastet e mëposhtme:

- Nëse gjatë periudhës për të cilën kërkohet leja, një pjesë e rëndësishme e punëtorëve me rrogë të një departamenti mungon dhe për këtë arsye organizimi i punës do të prekej rëndë;
- Nëse zëvendësimi i aplikantit të lejes për mësimin e gjuhës nuk mund të organizohet gjatë periudhës së paralajmërimit për shkak të specifikës së punës së kryer nga aplikanti apo një mungese krahu pune në degën apo profesionin e këtij ;
- Nëse puna ka natyrë sezonale dhe kërkesa i referohet periudhës që përkon me periudhën sezonale.

Leja për mësimin e gjuhës konsiderohet si periudhë pune efektive. Gjatë kohëzgjatjes së saj aplikohen dispozitat ligjore dhe rregulluese përsa i përket sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes në punë të përfituesit të saj.

Për rrogëtarët me kohë të pjesshme orët e lejes llogariten proporcionalisht. Leja mund të fraksionohet. Kohëzgjatja minimale është gjysmë ore në ditë.

**Kujdes: Ky tekst është vetëm një përmbledhje e hartuar nga ASTI asbl. Vetëm teksti i ligjit është i vlefshëm.**